



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 320/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV) me seli në Prishtinë, kundër qendrës se vendvotimit 1102b/08 Migjeni, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 320/2017 e datës 12.06.2017, e parashtuar nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër qendrës se vendvotimit nr.1102b/08R, Migjeni.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12.06.2014, nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se lidhur me vendvotimin numër 1102b/08 R, qendra e vendvotimit Migjeni në bazë të kësaj ankese kërkojmë rinumërimin e votave sepse vëzhguesit tanë te cilët na kanë dërguar materialin që Lëvizja Vetëvendosje i ka gjithë 102 vota në këtë vendvotim, komisioneri ynë përmes telefonit e konfirmon rezultatin e njëjtë. Në formularin e nënshkruar nga të gjithë komisioneret dhe nga kryesuesi i vendvotimit nga LDK, figuron 002 vota për LVV, në vend të 102 votave. Në listën për kandidatët të subjekteve politike figurojnë votat për kandidatë tonë ku Albin Kurti, i ka gjithsej 81 vota, çka i bie se subjekti ynë ka së paku 81 vota në këtë vendvotim. Si dëshmi ka bashkangjitur 8 fotografi të printuar. PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes

së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 320/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.*



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: "Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa", "Pristinë / Prishtina", and "Kryesuesi i Panelit". The signature is written in a cursive style.